



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 3-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 29.03.2022, në sallën e kuvendit, me fillim në ora 13⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
3. Fitim Shala, anëtar
4. Albiona Tasholli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Bytyqi, anëtare
7. Alban Salihu, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Shkelzen Hajdini, DSH
2. Valon Pacolli, DEZH
3. Elmaze Behluli, DA
4. Rexhep Rexhepi, DB
5. Imri Semetishti DUMJ
6. Kimete Jashanica, OSBE
7. Merita Bytyqi, Sektori i Kuvendit

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti *Merita Bytyqi*.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha rendin e ditës e keni marrë dhe të njëjtin e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 2-të e KPF-së.

2. Raporti vjetor janar-dhjetor 2021 i punës së Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe Drejtorive Komunale.
3. Propozim për miratimin e nëntë (9) Vendimeve për mbrojtjen e vlerës së natyrës në nëntë (9) lokacione të ndryshme, si monumente natyrore.
4. Projektvendim për përjashtimin nga pagesa e borxheve të qirasë jofitimprurëse të përfituesve të banesave sociale.
5. Projektvendim paraprak për shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.
6. Propozim-Vendim për krijimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të shfrytëzimit afatgjatë të pasurive të paluajtshme të Komunës në ZK Konjuh.
7. Propozim-Vendim për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Rininë (2022-2024) Lipjan.
8. Propozim-vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermerët.
9. Propozim-vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale.
10. Propozim-vendim për vazhdimin e organizimit të zgjedhjeve për zgjedhjen e këshillave dhe kryetarëve të këshillave vendorë.
11. Propozim-vendim për formimin e Komisionit për koordinimin e procesit zgjedhor të këshillave vendorë.

Pastaj Kryesuesi pyeti a ka vërejtje apo plotësime rreh rendit të ditës?

Pasi që nuk pati plotësime as vërejte kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja për punën e kësaj mbledhje me të gjitha votat, 6 për, aprovoi:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 2-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Albiona Tasholli, tha se ka një gabim teknik është harruar emri im, ne liste edhe pse unë kam qene prezent ne takim

Arsim Jashari, tha se edhe unë kam një propozim qe te na shënohet ne ekstrat ajo qe diskutojmë edhe pse e di qe e kane te e vështire.

Daut Azemi, tha se ne ekstrat ne i shënojmë në pika të shkurta vetëm përmbajtja dhe nganjëherë po flasim te gjithë dhe është pak vështire me i nxënë krejt

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 6 vota për:

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 2-të të KPF-së

Shtesë: Ekstrakti

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës

II

Raporti vjetor janar-dhjetor 2021 i punës së Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe Drejtorive Komunale.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi,i tha se raportet nuk i diskutojnë po propozoj qe te kalojnë direkt ne Kuvend .

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 6 vota për, , vendosi që raporti t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

III

Propozim për miratimin e nëntë (9) Vendimeve për mbrojtjen e vlerës së natyrës në nëntë (9) lokacione të ndryshme, si monumente natyrore.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishti drejtor i DPU, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se një propozim i mirë por është mirë edhe mirëmbajtja e objekteve të cilat po dëmtohen nga njerëzit e pa përgjegjshëm.

Imri Semetishti, tha se ne po mundohemi me i marr te gjitha masat per te bërë monitorimin e vazhdueshem.

Egzona Bytyqi, është mirë që nxënësve në shkollë me ju shpjeguar për rëndësinë e këtyre.

Fitim Shala, kur pritet me hy në fuqi ky vendim?

Imri Semetishti, tha se ky hyn ne fuqi pasi që te votohen ne kuvend shkon ne Ministri për konfirmim dhe publikohet në faqe të komunës pas 7 ditë të publikimit hyn ne fuqi

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 6 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

IV

Projektvendim për lirim nga pagesa e borxheve të qirasë jofitimprurëse të përfituesve të banesave sociale.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i a dha fjalën, Shkelzen Hajdini drejtor i DSH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Egzona Bytyqi, tha se jemi për këtë propozim pasi që është e mirë po ju ndalim ne ndihme këtyre familjeve ne këtë kohë krize dhe a ka banesa tjera për mu dhënë në shfrytëzim.

Arsim Jashari tha se a ka mekanizma qe i përcjellin përfituesit e këtyre banesave se a janë duke i plotësuar kushtet dhe e kane shkuar te personat e duhur këto banesa.

Albiona Tasholli, tha se një propozim vendim shumë i mirë qe e meriton përkrahjen ,një nder propozimet me te mira deri me tani.

Fitim Shala, tha se a do të bëhet vetëm larja e borxheve të këtyre banorëve të banesave apo si ka me qenë?

Shkelzen Hjadini, nuk e di a ka banesa tjera a jo, por ju njoftoj ne kuvend, ka mekanizëm qe i përcjell këto banesa pro a është funksional nuk e di.

Arsim Jashari, tha se kemi disa prona qe ju ka dhënë prona në shfrytëzim dhe është mirë me shkuar me i monitoruar këto prona.

Valon Pacolli, tha se kryetari e ka formuar një komision qe i monitoron këto prona

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

V

Propozim vendim paraprak për dhënien ne shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i dha fjalën,Valon Pacollit drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimvendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, a keni paraparë ndonjë marrëveshje për këto prona.

Valon Pacolli, po komisioni do të bëjnë te gjitha me kohë.

Fitim Shala, për sa kohë do të epen këto prona në shfrytëzim dhe a ka mekanizëm qe i përcjell këto prona.

Valon Pacolli, tha se këto prona ipen për 99 vite, edhe më herët e përmenda qe kryetari e ka caktua një komision qe do ti monitorojë këto prona.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të 7 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VI

Propozim-Vendim për krijimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të shfrytëzimit afatgjatë të pasurive të paluajtshme të Komunës në ZK Konjuh.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i dha fjalën, Valon Pacolli drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimvendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha votat për 6, dhe 1 abstenim vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VII

Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim të tokës-pronës për instalimin e transformatorit në Lipjan.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i dha fjalën, Imri Semetishti drejtor i DPU, i cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimvendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Fitim Shala, tha se a mudnet dikush tjetër me shfrytëzuar këtë pronë?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha votat për 7, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VIII

Propozim-Vendim për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Rininë (2022-2024) Lipjan.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i dha fjalën, Anila Reqica-Lugiqi drejtoreshë e DKRS, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se e përkrahi këtë propozim vendim por ajo që me befason që nuk ka ardhë asnjë propozim nga rinia. Pajtohem që të jetë edhe vullnetari i vitit. Kam një propozim që të jetë brenda planit edhe një komision që shkon nëpër shkollë që të diskutojnë rreth dukurive negative nëpër shkollë.

Elmaze Behluli tha se vitin e kaluar kemi mbajtur takime të tilla dhe kanë qenë të efektshme.

Daut Azemi, tha na duhet me diskutuar me DKA-në se a na lejohet me fut këtë ose jo.

Xhyla Dedushaj-Rexhepi, tha se cila është procedura me filluar implementimi i këtij plani.

Egzona Bytyqi, tha se kemi pas nevojë për një plan të tillë uroj që të jetë gjithëpërfshirës. Është mirë që me hy në këtë plan edhe promovimi i shëndetit publik.

Arsim Jashari, tha se mundet vetëm një organizatë me qenë përfituese.

Anila Reqica-Llugiuqi, tha pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi tani shpallet në faqe njoftimi dhe presim të fillojmë me zbatimin. E falënderojmë OSBE-në, për bashkëpunimin dhe ndihmën.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha votat për 7, vendosi që propozim vendimi të procedohet për shqyrtim Kuvendit.

IX

Propozim-vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermerët.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, ia dha fjalën, Rexhep Rexhepit drejtor i DB, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Rexhep Rexhepi, tha se e përkrahi këtë propozim vendim por është mirë që atyre që të ju ipet sera të punojnë e jo të marrin e të shfrytëzojnë për diçka tjetër.

Fitim Shala, tha është mirë që të formohet një komision që të dalë të verifikoj këto sera se apo punohen ose jo?

Alban Salihu, është mirë që këto sera me të monitorua, ose me të bërë një përqindje e parcitipimit, pasi që në shumicën e rasteve nuk po shfrytëzohen për bujqësi por për arsye tjera

Rexhep Rexhepi, tha se vitet e kaluara kemi pas raste që ju kanë konfiskuar motokultivatorët se bashku me policinë.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha votat për 7, vendosi që propozim vendimi të procedohet për shqyrtim Kuvendit.

X

**Propozim-vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare
Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale.**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i dha fjalën, Elamze Behluli, drejtoreshë e DA e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se punëtorët e admsinratës kanë bërë një punë të jashtëzakonshme sidomos në kohën e pandemisë dhe e meritojnë,por për këtë i kam rezervat e mia. Por jam që të shkoj në kuvend

Alban Salihu, tha se jemi me një situatë të vështirë dhe nuk e di se si do të veprojmë si grup do të diskutojmë brenda grupit për këtë temë. Jam që kjo pikë të shkojë në kuvend

Daut Azemi, kryesuesi i kuvendit tha se edhe vitet e kaluara kemi nda mjete, sindikata i ka mjete e veta por na vetëm një pjesë e kemi shtuar qe edhe kuvendi me kanë pjesë e këtij ekskursioni. Dhe ne rast se mjete mbeten kthehen ne komunë. Kemi pas rast qe janë kthyer 2 mijë euro mjete.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha votat për 7, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

XI

Propozim-vendim për vazhdimin e organizimit të zgjedhjeve për zgjedhjen e këshillave dhe kryetarëve të këshillave lokale

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i dha fjalën, Elamze Behluli, drejtoreshë e DA e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se kjo ndër pikat ma të mira qe ka një rendësi shumë të madhe. A do vazhdohet aty ku ka mbet a po do te fillohet nga e para.

Daut Azemi, tha se do të vazhdohet me pjesën ku ka mbet dhe ajo do te votohet ne kuvend pasi qe të zgjidhen te gjithë.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha votat për 7, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

XI

Propozim-vendim për formimin e Komisionit për koordinimin e procesit zgjedhor të këshillave vendorë.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i dha fjalën, Elamze Behluli, drejtoreshë e DA e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha votat për 7, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 14,⁴⁰

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Daut Azemi